



## Konferencë për shtyp me rastin e hapjes zyrtare të kampanjës senzibilizuese

### “ Rregullo Lejqëndrimin”

*Të nderuar të pranishëm, përfaqësues të mediave dhe portaleve informative*

Mirëserdhët në konferencën për shtyp me rastin e hapjes zyrtare të kampanjës senzibilizues “ Rregullo Lejqëndrimin” organizuar nga Unioni Studentor i Luginës së Preshevës në Maqedoni.

Në emër të kryesisë së USLPM-së më lejoni që fillimisht të bëjë një prezantim të shkurtër. USLPM është një shoqatë jo-qeveritare, jo-politike dhe jo-përfutuese e formuar me shoqërim të lirë të studentëve për të kryer veprimtari dhe aktivitete për zhvillimin e kulturës, humanizmit, sportit dhe vlera cilësore tjera të shoqërisë bashkëkohore. Si shoqatë e re e themeluar në Shkurt 2014, USLPM do të realizojë qëllimet e veta, detyrat dhe veprimtaritë në përputhje me ligjet të përcaktuara me Kushtetutën e R. Maqedonisë.

Pasi që kjo shoqatë është e themeluar dhe vepron në R.e Maqedonisë, vetë emri i saj është një përshkrues i grupit shoqërorë që i ka për bazë, studentët e Luginës së Preshevës që studiojnë në Maqedoni. Fatëmirësisht me themelimin e këtij Unioni studentët kanë mundësinë e gjetjes së një strehe të përbashkët ku do të realizojnë projekte dhe të gjejnë zgjidhje për sfidat që mund të hasin si student të huaj në këtë shtet. Rrjedhimisht, ky union i studentëve është dëshmitarë i vështirësive dhe paqartësive që studentët e Luginës së Preshevës po hasin në raport me rregullimin e dokumentit për lejqëndrim të përkohshëm në R. E Maqedonisë. Duke qenë viktime të neglizhencës së vet studentëve, apo procedurave të vonuara në institucionet të nevojshme për kompletimin e dokumenteve të kërkuara. Studentët tanë vazhdimisht po kthehen nga pikat kufitare për hyrje në R. E Maqedonisë e sidomos në kohën e fundit duke marrë ndalesa për hyrje ,si masa të rrepta të mos-përfilljes së kërkesave ligjore.

Qëndrimi i USLPM-së lidhur me çështjen e mos-rregullimit të dokumenteve është i prerë dhe në pajtueshmëri me ligjin, që do të thotë nuk e justifikon studentin e Luginës së Preshevës të mos e rregullojë atë. Si çdo qytetarë i huajnë R. e Maqedonisë edhe studentët e Luginës duhet t'i përmbahen ligjit. Ajo çfarë Unioni mund të ofrojë janë udhëzime, informacione dhe lehtësime në kompletimin e kësaj procedure.

Prandaj, që në themelim të saj, kjo shoqatë për tre muaj me radhë është munduar të bëjë diçka konkrete në mënyrë që studentët tanë të mos kthehen nga kufiri dhe eventualisht të mos ken ngecje në programet e tyre studimore.

Këshillat tonë drejtues që veprojnë në Tetovë dhe Shkup, si qendra studimore në të cilat numri i studentëve tanë është dukshëm më i koncentruar, kanë mbajtur takime me përfaqësues të lartë të institucioneve arsimore, përfaqësues të pushtetit lokal si dhe përpjekje për të kërkuar ndonjë afat mos-kthimi nga kufiri nga përfaqësues të organeve kompetente të R.M. Institucionet arsimore dhe stafi administrativ kanë deklaruar se janë në gjendje gatishmërie t'iu dalin në ndihmë studentëve për marrjen e dokumenteve të nevojshme. Kjo gjendje alarmante megjithatë është paraparë të zgjidhet dhe është parë nevoja të sensibilizohet me një kampanjë promovuese, i cili është hapi konkret që USLPM po bën në përpjekje për t'i dalë në ndihmë studentit të Luginës së Preshevës duke iu dejtuar me moton " Rregullo lejeqëndrimin, thuaj jo kthimit në kufi".

### **Çfarë ofron kjo kampanjë:**

1. Video promovuese dhe video sqaruese e dokumenteve të nevojshme për lejeqëndrim
2. Dy faza të ditëve promovuese për shpërndarjen e broshurave me sqarime të detajizuara për lejeqëndrim.
3. Pllakata informuese( promovuese) në insitucionet arsimore dhe më gjerë
4. Konsultime javore dhe elektronike me qëllim të informimit të drejt dhe efikas për studentët tanë në Preshevë dhe Bujanoc
5. Grumbullimi dhe dërgimi i dokumenteve në mënyrë të organizuar në Ambasadë
6. Orientimi i studentëve në zyrat më të afërta dhe më të lira për nostrifikim të dokumenteve të kërkuara

Pra, përmes këtyre elementeve promovuese urojmë që studentët tanë të kenë më të qartë procedurën e rregullimit të dokumenteve, fazat që ajo përfshinë dhe lehtësimet që ofrohen në këtë rast sidomos për ata studentë që nuk kanë të rregulluar lejeqëndrimin.

Si përfundim, mund të themi se si shoqatë joqeveritare ne jemi të vetëdëshëm për rëndësinë e rregullimit të lejeqëndrimeve nga ana e studentëve tanë, dhe fakti që kjo çështje po merr trajta problematike përbën një shqetësim për Unionin e vetë studentëve, prandaj, jemi të gatshëm që të shërbejmë si ndërmjetësues informativ e vullnetarë në shërbim të studentëve.

Për realizimin e kësaj kampanje senzibilizuese falenëderojmë: Shoqatën “Vizioni M”, Shtëpinë botuese “LOGOS A”, Shtypshkronja “Focus Print”, shoqatën “Dituria” si dhe “Librarinë e Çarshisë”. Po ashtu presim edhe bashkëpunim nga MPB.

Atëherë ne këtu e përmbylлим këtë takim, duke falenderuar mediat, të pranishmit. Përfundishmisht, i bëjmë apel studentëve tanë të kenë në konsideratë rëndësinë e rregullimit të lejeqëndrimeve, faktin që afati për rregullimin e saj zgjatë vetëm 90 ditë, prandaj ata studentë që planifikojnë të studiojnë në institucionet e arsimit të lartë në R. E Maqedoni duhet të startojnë këtë procedurë që nga muaji i 7-të i vitit.

**Skofiar Kamberi**

Kryetari i USLPM-së

Shkup

30 Maj ,2014